



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3720/ 11 prot.

Datë 04.02.2026

V E N D I M
Nr.205/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Timak” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-67990-11-06-2025, me objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, pajisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës për QKUM.”, me fond limit: 143,956,280.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues: Operatori ekonomik “Timak” SHPK me NIPT L62030020B dhe adresë: *Parku Industrial , Nr. 37, Rruga Egnatia, Tiranë*

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: *Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e

Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me
shkrim e pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e
lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në
përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar
dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë
arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimesit ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe
njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në
ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor
dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.11.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura
e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-67990-11-06-2025, me
objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, pajisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e
urgjencës për QKUM.”, me fond limit: 143,956,280.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën
09.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

II.2. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me datë 09.12.2025 autoriteti
kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 18.12.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës
me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të
Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nga ku rezulton për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1. OE "TIMAK" shpk	me vlerë	112,190,000	skualifikuar
2. OE "VIBTIS" shpk	me vlerë	128,000,000	skualifikuar
3. OE "MEKTRIN MOTORS" shpk	me vlerë	131,313,000	kualifikuar
4. BOE "Albadent Group" shpk & "Avel" shpk	me vlerë	139,666,007	skualifikuar
5. BOE "GTS-Gazra Teknike Shqiptare" shpk & "EDM" S.R.L Vat" shpk	me vlerë	142,480,000	skualifikuar

II.3.1. Referuar raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik operatori ekonomik "Timak" SHPK rezulton i skualifikuar për arsye se:

"TIMAK" SHPK, NUIS L62030020B skualifikohet për arsye se:

→ Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2, nenpiken 1, shkronjen a) pasi nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin (adresën përkatëse) apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi për këto rubrika, ne Pjesen II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, ne Formularin e Permbledhes te Vetdeklarimit, per te gjitha Seksionet perkatese si meposhte:

→ Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

→ Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

→ Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

→ Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

→ Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

→ Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

→ Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

→ Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

→ Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

→ Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

→ Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

→ Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Theksojme që ne mbështetje të LPP, Rregullave të Prokurimit Publik dhe qëndrimit të mbajtur nga KPP me ane të vendimit Nr.209/2025, date 07.02.2025 dhe vendimit Nr 816/2025, date 27.06.2025, Formulari Permbleddhes i Vetedeklarimit duhet të plotësohet në të gjithë seksionet e saj duke dhënë indicie për institucionin (adresën përkatëse) apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi për këto rubrika.

→ Nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 2, nenpiken 1, shkronjen a) pasi nga shqyrtimi i formularit Permbleddhes të Vetedeklarimit të ngarkuar në SPE konstatohet se “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit”, “A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT”, rezulton se nuk është deklaruar për personin në cilësinë e Administratorin, Znj. Manjola Kasneci dhe ortakun Znj. Arjeta Puca, në kundërshtim me sa kërkohet në këtë formular sipas të cilit: Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik [...] duhet të deklarohen se nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Znj. Manjola Kasneci në cilësinë e administratorit dhe detyrimisht duhej deklaruar në “Shkaqet e përjashtimit”, “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, si më sipër cituar. Administratori i një kompanie konsiderohet person që përfshihet në kategorinë e parashikuar nga formulari përmbledhës i vetedeklarimit për arsyen sepse ka kompetenca përfaqësuese të operatorit ekonomik. Me konkretisht dhe në këtë procedurë në cilësinë e administratorit Znj. Manjola Kasneci ka firmosur Formularin Permbleddhes të Vetedeklarimit, Oferten ekonomike, deklaratat e kerkuara etj pra rrjedhimisht Administratori hyn te personat që duhet të vetedeklarojnë, njësoj si anëtarët e organit administrativ, aksionarët kryesorë apo ortakët. Gjithashtu dhe Znj. Arjeta Puca në cilësinë e ortakut detyrimisht duhej deklaruar në “Shkaqet e përjashtimit”, “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, si më sipër cituar. Qendrim i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me ane të vendimit Nr 1375/2025, date 02.10.2025.

→ Gjithashtu referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se shoqëria “A V E L” shpk është importuesi zyrtar për automjetet Peugeot për Shqipërinë (sipas Autorizimit të Prodhuesit “Peugeot” dhe Distributorit Zyrtar të Autorizuar nga Prodhuesi “EUROIMPEX DOO Skopje”). Pra, në të njëjtën kohë shoqëria “A V E L” shpk në cilësinë e importuesi zyrtar për automjetet Peugeot për Shqipërinë ka autorizuar shoqërinë “TIMAK” shpk për të marrë pjesë dhe për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi (REF-67990-11-06- 2025) me

automjet Peugeot. Për sa më sipër, KVO vlerëson konstatimin e kushteve të ndërhyrjes në ofertë sipas parashikimeve të nenit 81 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi shoqëria “A V E L” shpk në cilësinë e importuesit dhe distributor zyrtar të automjeteve Peugeot për Shqipërinë, rezulton të jetë shoqëria e cila ka tagrin dhe mundësinë për përcaktimin e çmimit të automjeteve Peugeot në Republikën e Shqipërisë dhe si e tillë në rastin konkret ka marrë pjesë në procedurën e sipërcituar jo vetëm nëpërmjet ofertës së paraqitur drejtpërdrejt prej saj por në mënyrë indirekte edhe nëpërmjet ofertës së paraqitur nga shoqëria “TIMAK” shpk.

→ Për sa më sipër, deklaratimet e bëra në formularin e vetëdeklarimit nga shoqëria, “Seksioni B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” seksionin “Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër”, bëhen të pavlefshme dhe të paqenësishme, pasi në kuptim të këtij parashikimi: “fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë”, Në kushtet kur ky operator ka rakorduar për përcaktimin e çmimit me të vetmin distributor zyrtar të Peugeot në Shqipëri, i cili ka marrë pjesë në procedurë si konkurrent dhe të dy kanë ofertuar në procedurë, është fakt që tregon konsultime dhe përgatitje të ofertës jo në mënyrë të pavarur.”

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me datë 23.12.2025 është kryer publikimi i njoftimit të fituesit paraprak.

II.5. Në datën 29.12.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6221 dhe me nr. 3720/2025 prot., datë 29.12.2025 e operatorit ekonomik “Timak” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-67990-11-06-2025, me objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, pajisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës për QKUM.”, me fond limit: 143,956,280.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Timak”, në procedurën e mësipërme të prokurimit duke u shprehur për skualifikimin e tij se:

1. Operatori ekonomik “TIMAK” sh.p.k. ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit me Nr. REF-67990-11-06-2025, të zhvilluar nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara me objekt: Blerje autoambulanca (me sisteme, pajisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës për QKUM.

2. Me njoftimin e publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik date 18.12.2025, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vendosur skualifikimin e ofertës së ankimuesit, me arsyetimin se: “nuk është përmbushur kriteri i veçantë i kualifikimit, për shkak se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9) nuk janë dhënë indicie për institucionin, adresën ose dokumentacionin konkret mbi bazën e të cilit do të kryhej verifikimi për rubrikat që lidhen me

statusin aktiv dhe regjistrimin në QKB, mungesën e dënimeve penale, mungesën e shkeljeve të rënda profesionale, mungesën e falimentimit, shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike dhe regjistrimin e pronarëve përfitues.

3. Nga shqyrtimi i dokumentave të paraqitur nga operatori ekonomik "TIMAK" sh.p.k. rezulton se, ndonëse formulari i vetëdeklarimit nuk është plotësuar në aspektin formal (indicie, adresa, web etj) për çdo element të kërkuar janë ngarkuar në SPE dokumente zyrtare provuese, të lëshuara nga institucionet kompetente, të cilat provojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të plotë gjendjen faktike të operatorit ekonomik në momentin e ofertimit.

KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", nenet 2, 3 dhe 82 të tij, si dhe neni 26 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

ANALIZA LIGJORE DHE SHKELJET E PRETENDUARA

4. Nga interpretimi sistematik dhe teleologjik i nenit 82 të ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 26 të VKM nr. 285/2021 rezulton se Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është parashikuar si qëllim në vetvete, por si instrument procedural me funksion lehtësues, i pranuar si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta. Ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht se dokumentet provuese kërkohen në një fazë të mëvonshme të procedurës, konkretisht nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit. Kjo ndarje e qartë normative ndërmjet fazës së vetëdeklarimit dhe fazës së provimit dokumentar tregon se qëllimi i formularit është lehtësimi procedural dhe jo krijimi i një pengese formale përjashtuese.

5. Në rastin konkret, operatori ekonomik "TIMAK" sh.p.k. ka vepruar përtej funksionit lehtësues të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, duke paraqitur drejtpërdrejt në Sistemin e Prokurimit Elektronik dokumentet zyrtare që ligji parashikon të kërkohen në një fazë të mëvonshme të procedurës, dhe duke vënë në dispozicion informacionin që synon Formulari i Vetëdeklarimit. Konkretisht:

a) operatori ekonomik ka depozituar ekstraktin e shoqërisë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, nga i cili rezulton statusi aktiv i shoqërisë dhe përfshirja e veprimtarisë në objektin e prokurimit; për sa kohë është paraqitur dokument zyrtar nga organi përgjegjës, deklarimi orientues i adresës elektronike të QKB-së nuk paraqet më nevojë praktike apo juridike;

b) janë dorëzuar vërtetime zyrtare nga gjykata dhe prokuroria për subjektin dhe administratorin, si dhe dëshmi penaliteti për ortakët dhe administratorin, duke siguruar në mënyrë të plotë dhe të pakundërshtueshme informacionin që mbulon rubrika përkatëse e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit; në këto kushte, arsyetimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për këtë element rezulton i pabazuar;

c) operatori ekonomik ka paraqitur vërtetim debie për energjinë elektrike, duke provuar shlyerjen e detyrimeve përkatëse me dokument zyrtar dhe jo thjesht përmes një deklarimi orientues mbi bazën e të dhënave të OSHEE-së;

ç) janë depozituar vërtetime nga administrata tatimore dhe sigurimet shoqërore, që dëshmojnë përmbushjen e të gjitha detyrimeve fiskale dhe kontributive, duke realizuar plotësisht qëllimin e rubrikave përkatëse të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit;

d) operatori ekonomik ka bashkëlidhur shkresë zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, e cila konfirmon se nuk ndodhet në listën e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, duke e bërë rubrikën përkatëse të vetëdeklarimit të plotësuar në substancë;

dh) është depozituar ekstrakti i regjistrimit të pronarëve përfitues, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi

e) lidhur me rubrikën e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas së cilës “operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi”, theksohet se kjo deklaratë nuk korrespondon me ekzistencën e një institucioni të vetëm apo një baze të veçantë të dhënash që lëshon një dokument me përmbajtje të tillë në mënyrë të unifikuar. Përmbushja e kësaj kërkesë ligjore vërtetohet në mënyrë të shpërndarë dhe të tërthortë përmes dokumentacionit zyrtar të paraqitur për rubrikat e tjera të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, përfshirë statusin aktiv të shoqërisë, mungesën e dënimeve penale, përmbushjen e detyrimeve fiskale dhe kontributive, shlyerjen e detyrimeve ndaj energjisë elektrike, regjistrimin e pronarëve përfitues dhe mungesën e masave përjashtuese nga prokurimi publik. Në këto kushte, kjo rubrikë përfaqëson një deklarament me karakter të përgjithshëm, sintetik dhe përmbledhës, i cili konsiderohet i përmbushur në substancë për sa kohë janë provuar të gjitha elementet konkrete që përbëjnë respektimin e kërkesave ligjore në fuqi.

6. Të gjitha dokumentet e sipërcituara janë të lëshuara nga institucionet kompetente, janë të verifikueshme dhe provojnë gjendjen faktike të operatorit ekonomik në kohën e ofertimit, në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 26, pika 6 të VKM nr. 285/2021. Në këto rrethana, autoriteti kontraktor ka pasur në dispozicion prova më të forta dhe më të sigurta sesa vetëdeklarimi, çka përjashton çdo paqartësi apo pamundësi reale verifikimi dhe e bën të pajustificuar skualifikimin e operatorit ekonomik për mungesë thjesht formale.

7. Kërkesa për shoqërimin e vetëdeklarimit me indicie mbi institucionin ose bazën e të dhënave, e parashikuar në nenin 26, pika 3 të VKM nr. 285/2021, gjen zbatim vetëm në rastet kur informacioni ndodhet në një bazë të dhënash që autoriteti kontraktor duhet ta aksesojë drejtpërdrejt. Në rrethanat faktike të kësaj çështjeje, një akses i tillë nuk ishte i nevojshëm, pasi dokumentacioni provues ishte tashmë i paraqitur në sistem. Zbatimi i kësaj dispozite në mënyrë absolute, të shkëputur nga realiteti faktik, përbën keqinterpretim të normës dhe e zhvesh atë nga funksioni i saj praktik.

8. Si pasojë e këtij interpretimi formalist, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka ndërmarrë masën më të rëndë procedurale – skualifikimin – në një situatë ku mangësia e konstatuar është thjesht formale dhe pa ndikim material në vlerësimin e aftësisë dhe besueshmërisë së operatorit ekonomik. Një qasje e tillë cenon parimin e proporcionalitetit, pasi pasojat e vendimit janë dukshëm të tepruara në raport me natyrën e mangësisë së konstatuar, si dhe parimin e konkurrencës dhe trajtimit të barabartë, duke përjashtuar nga procedura një operator që ka provuar në thelb përmbushjen e kriterëve të kualifikimit.

9. Për më tepër, ky vendim bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me qëllimin dhe parimet themelore të ligjit nr. 162/2020, të parashikuara në nenet 2 dhe 3 të tij. Skualifikimi i operatorit ekonomik “TIMAK” sh.p.k., pavarësisht përmbushjes reale dhe të provuar të kriterëve, nuk rrit eficiencën dhe efikasitetin e procedurës, nuk nxit konkurrencën dhe nuk siguron trajtim të barabartë e jodiskriminues, por përkundrazi ngushton artificialisht konkurrencën, në kundërshtim

me ndalimin e shprehur të ligjit për praktika të tilla.

10. Në këtë kuadër, shkeljet e konstatuara nuk janë thjesht procedurale, por thelbësore, pasi prekin drejtpërdrejt mënyrën se si ligji për prokurimin publik duhet të zbatohet në praktikë. Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është rezultat i një formalizmi të tepër, që e zhvendos fokusin e procedurës nga vlerësimi real i kapaciteteve dhe besueshmërisë së operatorëve ekonomikë drejt një zbatimi mekanik të formës, në kundërshtim me frymën, qëllimin dhe parimet e ligjit nr. 162/2020.

Për rrjedhojë, vendimi i kundërshtuar rezulton i pabazuar në ligj dhe nuk mund të qëndrojë në fuqi.

Për sa më sipër, kërkojme:

1. Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga Operatori Ekonomik “TIMAK” sh.p.k.;
2. Kualifikimin e operatorit ekonomik “TIMAK” sh.p.k. dhe vijimin e procedurës së prokurimit me këtë operator, i renditur i pari, në përputhje me ligjin.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin e publikimit me nr. 3720/1 prot., datë 29.12.2025 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes “Timak” SHPK.

II.6. Me datë 31.12.2025 operatori ekonomik “Mektrin Motors” SHPK ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike formularin e argumentave i cili u protokollua me tonën me nr.3720/2 prot., datë 05.01.2026.

II.7. Me kërkesën me objekt “Për konstatimin e mospërputhshmërisë ndërmjet arsyeve të pasqyruara në Formularin për publikim Nr 3720/1 prot., datë 29.12.2025, dhe arsyeve të skualifikimit të njoftuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) për vendimin e vlerësimit/klasifikimit perfundimtar” protokolluar me tonën me nr. 3720/3 prot., datë 06.01.2025 operatori ekonomik “Timak” SHPK i ka kërkuar KPP: “1. Të konstatojë faktin e mospërputhshmërisë ndërmjet arsyeve të skualifikimit të pasqyruara në Formularin Nr. 3720/1 prot., datë 29.12.2025, në raport me arsyet e njoftuara zyrtarisht në SPE dhe të bëjë korrigjimet respektive;

2. Shqyrtimi i ankesës të kufizohet vetëm në arsyet e skualifikimit të komunikuar ligjërisht dhe në mënyrë të rregullt nga autoriteti kontraktor në SPE;

3. Të mos marrë në konsideratë në asnjë formë arsyet e skualifikimit që nuk i janë adresuar operatorit ekonomik “Timak” SHPK në fazën e vlerësimit dhe klasifikimit perfundimtar. Në të kundërt të merren në konsideratë kundërshtimet e sipërpërmendura të paraqitura nga OE Timak shpk.”

II.8. Të njëjtën kërkesë si më sipër sëbashku me dokumentacionin bashkëngjitur, komunikimin e kryer nga operatori ekonomik “Timak” SHPK me Agjencinë e Prokurimit Publik, dhe përgjigjen e kësaj të fundit, ankimesi ja ka dërguar KPP edhe përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) i cili u protokollua me tonën me nr. 3720/8 datë 03.02.2025.

II.9. Me datë 06.01.2026 është ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimi i autoritetit kontraktor për shqyrtimin e ankesës “Vendim K.SH.A nr. 03/2026” me nr. 3691/7

prot., datë 06.01.2026 nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës duke argumentuar si vijon:

“

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vëren se ankimuesi në sistemin e prokurimeve elektronike është skualifikuar për 3 (tre) arsye skualifikimi, ndërkohë në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor dhe KPP, ka ngritur pretendime vetëm për 2 (dy) arsye skualifikimi që konkretisht lidhen me mosplotësimin e formularit të vetëdeklarimit në të gjitha seksionet përkatëse dhe mosdeklarimi për personin apo personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, që ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, se nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për

ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Për arsyen tjetër të sipërcituar ankimuesi nuk ka parashtuar asnjë fakt/argument me anë të të cilit të kundërshtojë pretendimet e autoritetit kontraktor lidhur me konstatimin e kushteve të ndërhyrjes në ofertë sipas parashikimeve të nenit 81 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku shoqëria “A V E L” shpk, në cilësinë e importuesit dhe distributor zyrtar të automjeteve Peugeot për Shqipërinë, rezulton të jetë shoqëria e cila ka tagrin dhe mundësinë për përcaktimin e çmimit të automjeteve Peugeot në Republikën e Shqipërisë dhe si e tillë në rastin konkret ka marrë pjesë në procedurën e sipërcituar jo vetëm nëpërmjet ofertës së paraqitur drejtpërdrejt prej saj në cilësinë e bashkimit të Operatorëve, por në mënyrë indirekte edhe nëpërmjet ofertës së paraqitur nga shoqëria “TIMAK” shpk, në këtë procedurë prokurimi (REF-67990-11-06-2025) me automjet Peugeot.

Në këtë kuptim KSHA gjykon se ankimi i paraqitur prej operatorit ekonomik ankimues nuk mund të konsiderohet i plotë referuar kundërshtimit të të gjitha arsyeve të skualifikimit, pasi OE “TIMAK” shpk ka kundërshtuar vetëm arsyet e skualifikimit për plotësimin e Formularit të Vetëdeklarimit.

Ankimuesi në cilësinë e të interesuarit që ka iniciuar procedurën e ankimit ka barrën e provës për të kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij, në përputhje me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, si edhe me nenin 82 “Barra e provës” të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në referencë dhe në zbatim të frymës ligjore, operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij dhe të japë argumenta konkretë që dëshmojnë se ai i përmbush kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

KSHA gjykon se mosankimimi në tërësi i arsyeve të skualifikimit bën që operatori ekonomik “TIMAK” shpk të mbetet i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi, cildo qoftë fati i arsyeve të tjera të skualifikimit për të cilën ankimuesi ka iniciuar procedimin administrativ. Neni 109, pika 1, i Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me titull “E drejta e ankimit” parashikon se: *“Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit ose entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”* Neni 109, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ushtrimit të të drejtës së ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtuara në ankimin e tij në lidhje me arsyet e skualifikimit lidhur me mosdorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të plotësuar sipas mënyrës së

duhur për të gjitha Seksionet perkatese do të pranoheshin nga KSHA, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës pasi, për një arsye skualifikimi nuk ka ngritur asnjë pretendim për kundërshimin e saj, çka sjell që gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik ankimues do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë e prokurimit, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk merren në shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “TIMAK” shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.10. Vendimin më sipër për shqyrtimin e ankesës autoriteti kontraktor e dërgoi në KPP edhe përmes shërbimit postar i cili u protokollua me tonën me nr. 3720/5 prot., datë 08.01.2026.

II.11. Me kërkesën me nr. 19 prot., datë 08.01.2026, operatori ekonomik “Timak” SHPK i është drejtuar KPP me kërkesën dhe dokumentacionin bashkëngjitur (ndër të cilët edhe printime ekrani të arsyeve të skualifikimit) për: *“1. Konstatimin e mospërputhshmërisë ndërmjet arsyeve të skualifikimit të pasqyruara në Formularin për publikim Nr. 3720/1 prot., datë 29.12.2025, dhe arsyeve të skualifikimit të njoftuara operatorit ekonomik në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) në kuadër të vendimit të vlerësimit dhe klasifikimit përfundimtar;*

2. Mosmarrjen në konsideratë të arsyetimit të përfshirë në vendimin e K.SHA Nr/03/2026, Nr 3691/7 prot, datë 06.01.2026 për refuzimin e ankimit në pjesën që lidhet me pretendimin për skualifikimin për shkak të ndërhyrjes në ofertë, si një arsye që nuk rezulton e njoftuar në mënyrë të rregullt përmes SPE ndaj operatorit ekonomik;

3. Në rast se çmohet e kundërta, vlerësimin në themel të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së arsyeve të skualifikimit nga KPP-ja përfshirë edhe arsyen e pretenduar që lidhet me ndërhyrjen në ofertë, në funksion të një shqyrtimi të plotë dhe efektiv ankimi, duke pranuar pretendimet e OE Timak shpk lidhur me arsyen e skualifikimit “ndërhyrje më ofertë”. ”

II.12. Nga verifikimi i përmbajtjes së ankimit administrativ me numër ankimi elektronik A/2025/6221 dhe me nr. 3720/2025 prot., datë 29.12.2025 të paraqitur nga operatorit ekonomik “Timak” SHPK njëherazi në KPP dhe autoritet kontraktor për procedurën e prokurimit të sipërcituar rezulton se operatori ekonomik “Timak” SHPK ka ankimuar arsyen e parë dhe të dytë të skualifikimit por nuk ka ankimuar arsyen e tretë ku sipas vlerësimit të KVO jemi në kushtet e ndërhyrjes në ofertë sipas parashikimeve të nenit 81 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi shoqëria “A V E L” shpk në cilësinë e importuesit dhe distributor zyrtar të automjeteve Peugeot për Shqipërinë, rezulton të jetë shoqëria e cila ka tagrin dhe mundësinë për përcaktimin e çmimit të automjeteve Peugeot në Republikën e Shqipërisë dhe si e tillë në rastin konkret ka marrë pjesë në procedurën e sipërcituar jo vetëm nëpërmjet ofertës së paraqitur drejtpërdrejt prej saj por në mënyrë indirekte edhe nëpërmjet ofertës së paraqitur nga shoqëria “TIMAK” shpk.

Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës, me shkresën nr. 3720/7 prot., datë 28.01.2026, KPP iu drejtua operatorit ekonomik ankimues dhe autoritetit kontraktor duke kërkuar paraqitjen e tyre në mjediset e KPP-së me datë 02.02.2026 ora 12:00 për zhvillimin e një seance dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik “Timak” SHPK dhe përfaqësues të autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A, të cilët duhet të jenë anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave që disponojnë të dhënat për tu futur në llogaritë përkatëse në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.13. Në datën 02.02.2026 në mjediset e KPP u zhvillua seanca dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik ankimues “Timak” SHPK dhe përfaqësues të autoritetit kontraktor, anëtarë të KVO-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Timak” SHPK mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, KPP vëren se,

III.1.2. Në datën 29.12.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6221 dhe me nr. 3720/2025 prot., datë 29.12.2025 e operatorit ekonomik “Timak” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-67990-11-06-2025, me objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, pajisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës për QKUM.”, me fond limit: 143,956,280.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Timak”, në procedurën e mësipërme të prokurimit dhe ku

përmbajtja e ankesës është pasqyruar në seksionin II “Rrethanat e çështjes” pika II.5 të këtij vendimi.

III.1.3. Referuar raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik operatori ekonomik “Timak” SHPK rezulton i skualifikuar për arsye se:

“TIMAK” SHPK, NUIS L62030020B skualifikohet për arsye se:

→ Nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, pikën 2, nën pikën 1, shkronjën a) pasi nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin (adresën përkatëse) apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi për këto rubrika, në Pjesën II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, në Formularin e Përmbledhës të Vetdeklarimit, për të gjitha Seksionet përkatëse si mëposhte:

→ Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

→ Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

→ Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

→ Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi.

→ Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

→ Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

→ Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

→ Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

→ Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

→ Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

→ Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose

me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

→ Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Theksojme që ne mbështetje të LPP, Rregullave të Prokurimit Publik dhe qëndrimit të mbajtur nga KPP me ane të vendimit Nr.209/2025, datë 07.02.2025 dhe vendimit Nr 816/2025, datë 27.06.2025, Formulari Permbledhës i Vetedeklarimit duhet të plotësohet në të gjithë seksionet e saj duke dhënë indicie për institucionin (adresën përkatëse) apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi për këto rubrika.

→ Nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 2, nenpiken 1, shkronjen a) pasi nga shqyrtimi i formularit Permbledhës të Vetedeklarimit të ngarkuar në SPE konstatohet se “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit”, “A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT”, rezulton se nuk është deklaruar për personin në cilësinë e Administratorin, Znj. Manjola Kasneci dhe ortakun Znj. Arjeta Puca, në kundërshtim me sa kërkohet në këtë formular sipas të cilit: Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik [...] duhet të deklarohen se nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Znj. Manjola Kasneci në cilësinë e administratorit dhe detyrimisht duhej deklaruar në “Shkaqet e përjashtimit”, “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, si më sipër cituar. Administratori i një kompanie konsiderohet person që përfshihet në kategorinë e parashikuar nga formulari përmbledhës i vetedeklarimit për arsyen sepse ka kompetenca përfaqësuese të operatorit ekonomik. Me konkretisht dhe në këtë procedurë në cilësinë e administratorit Znj. Manjola Kasneci ka firmosur Formularin Permbledhës të Vetedeklarimit, Oferten ekonomike, deklaratat e kërkuara etj pra rrjedhimisht Administratori hyn në personat që duhet të vetedeklarojnë, njësoj si anëtarët e organit administrativ, aksionarët kryesorë apo ortakët. Gjithashtu dhe Znj. Arjeta Puca në cilësinë e ortakut detyrimisht duhej deklaruar në “Shkaqet e përjashtimit”, “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, si më sipër cituar. Qëndrim i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me ane të vendimit Nr 1375/2025, datë 02.10.2025.

→ Gjithashtu referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se shoqëria “A V E L” shpk është importuesi zyrtar për automjetet Peugeot për Shqipërinë (sipas Autorizimit të Prodhuesit “Peugeot” dhe Distributorit Zyrtar të Autorizuar nga Prodhuesi “EUROIMPEX DOO Skopje”). Pra, në të njëjtën kohë shoqëria “A V E L” shpk në cilësinë e importuesit zyrtar për automjetet Peugeot për Shqipërinë ka autorizuar shoqërinë “TIMAK” shpk për të marrë pjesë dhe për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi (REF-67990-11-06- 2025) me automjet Peugeot. Për sa më sipër, KVO vlerëson konstatimin e kushteve të ndërhyrjes në ofertë sipas parashikimeve të nenit 81 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi shoqëria “A V E L” shpk në cilësinë e importuesit dhe distributor zyrtar të automjeteve Peugeot për Shqipërinë, rezulton të jetë shoqëria e cila ka tagrin dhe mundësinë për përcaktimin e çmimit të automjeteve Peugeot në Republikën e Shqipërisë dhe si e tillë në rastin konkret ka marrë pjesë në procedurën e

sipërcituar jo vetëm nëpërmjet ofertës së paraqitur drejtpërdrejt prej saj por në mënyrë indirekte edhe nëpërmjet ofertës së paraqitur nga shoqëria “TIMAK” shpk.

→ Për sa më sipër, deklarinimet e bëra në formularin e vetëdeklarimit nga shoqëria, “Seksioni B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” seksionin “Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër”, bëhen të pavlefshme dhe të paqenësishme, pasi në kuptim të këtij parashikimi: “fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë”, Në kushtet kur ky operator ka rakorduar për përcaktimin e çmimit me të vetmin distributor zyrtar të Peugeot në Shqipëri, i cili ka marrë pjesë në procedurë si konkurrent dhe të dy kanë ofertuar në procedurë, është fakt që tregon konsultime dhe përgatitje të ofertës jo në mënyrë të pavarur.”

III.1.4. Mbi bazën e arsyeve të skualifikimit të përcaktuara në raportin e auditit në SPE të cilat nga verifikimet rezultojnë të jenë të njëjta me ato të njoftimit të fituesit të publikuar në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.83, datë 29 Dhjetor 2025, KPP publikoi në regjistrin e ankesave Formularin për Publikim me nr. 3720/1 prot., datë 29.12.2025 me të tri arsyet e sipërcituara të skualifikimit.

Ndërkohë nga verifikimi i përmbajtjes së ankimit administrativ me numër ankimi elektronik A/2025/6221 dhe me nr. 3720/2025 prot., datë 29.12.2025 të paraqitur nga operatorit ekonomik “Timak” SHPK njëherazi në KPP dhe autoritet kontraktor për procedurën e prokurimit të sipërcituar rezulton se operatori ekonomik “Timak” SHPK ka ankimuar arsyen e parë dhe të dytë të skualifikimit por nuk ka ankimuar arsyen e tretë ku sipas vlerësimit të KVO jemi në kushtet e ndërhyrjes në ofertë sipas parashikimeve të nenit 81 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi shoqëria “A V E L” shpk në cilësinë e importuesit dhe distributor zyrtar të automjeteve Peugeot për Shqipërinë, rezulton të jetë shoqëria e cila ka tagrin dhe mundësinë për përcaktimin e çmimit të automjeteve Peugeot në Republikën e Shqipërisë dhe si e tillë në rastin konkret ka marrë pjesë në procedurën e sipërcituar jo vetëm nëpërmjet ofertës së paraqitur drejtpërdrejt prej saj por në mënyrë indirekte edhe nëpërmjet ofertës së paraqitur nga shoqëria “TIMAK” shpk.

Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës, me shkresën nr. 3720/7 prot., datë 28.01.2026, KPP iu drejtua operatorit ekonomik ankimues dhe autoritetit kontraktor duke kërkuar paraqitjen e tyre në mjediset e KPP-së me datë 02.02.2026 ora 12:00 për zhvillimin e një seance dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik “Timak” SHPK dhe përfaqësues të autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A, të cilët duhet të jenë anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave që disponojnë të dhënat për tu futur në llogaritë përkatëse në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

III.1.5. Në datën 02.02.2026 ora 12:00 në mjediset e KPP u zhvillua seanca dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik ankimues “Timak” SHPK dhe përfaqësues të autoritetit kontraktor, anëtarë të KVO-së. Në këtë seancë e cila u regjistrua audio ne sistemin e ankesave elektronike nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, ju kërkuar secilës nga palët duke filluar nga përfaqësuesit e KVO-së që të logohen në sistem për të verifikuar arsyet e

plota të skualifikimit të paraqitura në SPE nga ana e tyre, si dhe arsyet e skualifikimit me të cilat është njohur realisht ankimuesi “Timak” SHPK. Në këtë mënyrë ju kërkua anëtarit të KVO-së së autoriteti kontraktor i pranishëm në seancë që të logohej në llogarinë e tij të përdorimit të faqes së Agjencisë së Prokurimit Publik www.gov.al për të verifikuar arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik “Timak” SHPK. Rezultoj e provuar në seancë se sipas raportit të auditit të shkarkuar nga anëtari i KVO në llogarinë e tij në SPE ishin tri arsye skualifikimi ashtu siç edhe KPP kishte pasqyruar në formularin për publikim nr. 3720/1 prot., datë 29.12.2025. Ky raport auditit u printua dhe u nënshkrua nga të gjitha palët dhe u bë pjesë e fashikullit të shqyrtimit administrativ. Ndërkohë që përfaqesuesit të operatorit ekonomik pasi konfirmoi edhe një herë në seancë se nuk kanë marrë dijeni lidhur me arsyen e tretë të skualifikimit ku sipas vlerësimit të KVO jemi në kushtet e ndërhyrjes në ofertë sipas parashikimeve të nenit 81 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ju kërkua nga KPP që të logohej në llogarinë e tij të përdorimit të faqes së Agjencisë së Prokurimit Publik www.gov.al dhe të kontrollojë rubrikën “mesazhe” për mesazhet e marra nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi. Nga kontrolli i mesazheve të marra në rubrikën “mesazhe” në llogarinë e ankimuesit rezultoi, se ky i fundit ka marrë dy njoftime për këtë procedurë prokurimi, konkretisht:

-Vlerësime për tenderin Blerje autoambulanca (me sisteme, pajisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës për QKUM, me datë të marrjes së njoftimit 18.12.2025 ora 15:33 për procedurën e prokurimit me nr. REF-67990-11-06-2025;

dhe

- oferta juaj OFFER-9575/0812205 është refuzuar, me datë të marrjes së njoftimit 18.12.2025 ora 15:33 për procedurën e prokurimit me nr. REF-67990-11-06-2025.

Nga verifikimi i përmbajtjes së njoftimit *Vlerësime për tenderin Blerje autoambulanca (me sisteme, pajisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës për QKUM, me datë të marrjes së njoftimit 18.12.2025 ora 15:33 për procedurën e prokurimit me nr. REF-67990-11-06-2025* rezultoi se nuk ishin pasqyruar të gjitha arsyet e skualifikimit. Ndërsa në njoftimin *oferta juaj OFFER-9575/0812205 është refuzuar*, i cili rezulton të ketë të njëjtën datë dhe orë (18.12.2025 ora 15:33) me njoftimin e parë, janë pasqyruar të tri arsyet e skualifikimit sic rezultojnë në raportin e auditit në SPE dhe ku mbi bazën e të cilit KPP publikoi edhe formularin për publikim me nr. 3720/1 prot., datë 29.12.2025. Gjithashtu, u bë dhe printimi i ekranit (print screen) i përmbajtjes së secilit prej njoftimeve më sipër të cilët u nënshkruan nga palët dhe u bënë pjesë e materialit të fashikullit të shqyrtimit administrativ.

III.1.6. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.1.7. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e

prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.8. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin Elektronik të Ankesave .”

III.1.9. Në rastin konkret referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, veprimeve procedurale të kryera në seancën dëgjimore të datës 02.02.2026 dhe përmbajtjes së raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se autoriteti kontraktor ka paraqitur tri arsye skualifikimi të cilat KPP i ka pasqyruar në formularin për publikim me Nr. 3720/1 prot., datë 29.12.2025, ndërsa referuar përmbajtjes së ankesës, ankimuesi nuk ka shfaqur asnjë pretendim mbi arsyen e tretë të skualifikimit ku sipas vlerësimit të KVO kjo arsye lidhet me kushtet e ndërhyrjes në ofertë sipas parashikimeve të nenit 81 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Gjithashtu nga kontrolli i mesazheve të marra në rubrikën “mesazhe” në llogarinë e ankimuesit rezultoi, se në të njëjtën datë dhe orë ankimuesi ka marrë dy njoftime për këtë procedurë prokurimi, ku njoftimi i dytë “*oferta juaj OFFER-9575/0812205 është refuzuar*” në ndryshim nga i pari ka pasqyruar të tri arsyet e skualifikimit të KVO të cilat rezultojnë në raportin e auditit pjesë e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ. Duke marrë shkas edhe nga deklarimet e ankimuesit në seancë dëgjimore se kemi parë në sistem arsyet e skualifikimit të cilat në dy mesazhe të ndryshme janë me përmbajtje të ndryshme dhe nuk mund të hamendësojmë që të kontrollojmë të dy mesazhet, KPP gjykon se barra e provës sipas parimit të **onus probandi incumbit ei qui dicit** (barrën e provës e mban ai që pretendon) bie mbi ankimuesin për të konfirmuar se në asnjë prej mënyrave që legjislacioni dhe sistemi i prokurimit elektronik parashikon nuk ka patur mundësi të njihet me të gjitha arsyet e skualifikimit mbi bazën e të cilave të prapësonte në mënyrë shteruese përmes instrumentit të ankimit administrativ brenda afateve të përcaktuara ligjore. Kjo kërkesë nuk është një formalitet teknik, **por një garanci ligjore për gjurmueshmërinë, transparencën dhe barazinë e operatorëve ekonomikë**, e cila lidhet ngushtë me legjitimitetin dhe vlefshmërinë e procesit ankimues. Në rastin konkret pavarësisht se ankimuesi ka marrë dy njoftime të ndryshme, ka patur mundësinë të njihet me të gjitha arsyet e skualifikimit të shprehura në njoftimin e dytë në të njëjtën datë dhe orë me njoftimin e parë. **Mungesa e çdo përpjekjeje për të kontrolluar edhe përmbajtjen e njoftimit të dytë ku janë paqyruar të gjitha arsyet e skualifikimit, e lë operatorin në pozicionin e një subjekti që nuk ka**

ushtruar në mënyrë shteruese të drejtën e tij të ankimit. Në këtë kuptim, **mosushtrimi i ankimit për të gjitha arsyet e skualifikimit brenda afateve të parashikuara nga nenin 110 pika 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar nuk përbën në asnjë mënyrë mohimin e së drejtës për ankimim, por është rezultat i mosushtrimit të saj në mënyrën shteruese nga vetë subjekti që pretendon shkeljen.** E drejta për ankim ekziston dhe është e garantuar, por **nuk mund të ushtrohet sipas vullnetit subjektiv të operatorit** pasi do të përmbyseshin parimet e sigurisë juridike dhe barazisë në procedurë, duke krijuar standarde të dyfishta dhe vendimmarrje arbitrare.

Mungesa e kontrollit mbi përmbajtjen e mesazhe në llogarinë e tij **nuk janë pengesa të pajustificuara ose të pakalueshme për të drejtën për një ankim efektiv.** Në rastin në fjalë, nuk kemi të bëjmë me ndonjë pengesë të pakapërcyeshme apo me ndonjë mohimin formal të qasjes në ushtrimin e ankimit administrativ, por me **mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik të përgjegjësive të tij.**

Në këtë kuadër KPP vëren, se operatori ekonomik ankimues nuk i ka ezauruar të gjitha shkallët e ankimit në lidhje me pretendimet e tij mbi arsyet e skualifikimit nga autoriteti kontraktor pasi për arsyen e tretë të skualifikimit (e cila rezulton e provuar nga materialet e fashikullit të shqyrtimit administrativ) nuk ka shfaqur pretendime në formularin e ankesës duke sjellë në këtë mënyrë edhe rënien në dekadencë të së drejtës së tij dhe humbjen e afatit të ankimit në lidhje me këtë pretendim në kuptim të nenit 110 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar . Në këtë kuadër KPP gjykon, se edhe pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues mbi arsyen e skualifikimit nga autoritetit kontraktor të cilat i ka shprehur në formularin e ankesës nuk do të merret në shqyrtim, pasi edhe nëse hipotetikisht ato do të qëndronin, operatori ekonomik ankimues do të vazhdojë të mbetet i skualifikuar për arsye se ai për faj të tij nuk ka ezauruar shkallët e ankimit për arsyen e tretë të skualifikimit që lidhet me paraqitjen e ofertës në mënyrë jo të pavarur.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Timak” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Timak” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-67990-11-06-2025, me objekt “Blerje autoambulanca (me sisteme, pajisje dhe aparatura mjekësore) për

shërbimin e urgjencës për QKUM.”, me fond limit: 143,956,280.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Timak” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

